



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



PLANI KOMUNAL PËR INTEGRITET

2024 - 2026

Raporti

Periudha janar – qershor 2026

Gusht '2026

Deklarata e Integritetit

Periudha janar–qershor 2026 shënoi një fazë të rëndësishme të konsolidimit institucional dhe të zbatimit të politikave që forcojnë integritetin në Komunën e Gjilanit.

Pas miratimit në kohë të buxhetit për vitin 2026, institucionet komunale krijuan kushtet për planifikim më të qëndrueshëm, vendimmarrje më efikase dhe realizim të projekteve në përputhje me interesin publik.

Gjatë kësaj periudhe, prioriteti ynë ka qenë që çdo vendim institucional të mbështetet në parimet e ligjshmërisë, transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë ndaj qytetarëve.

Përmes raportimit të rregullt financiar, konsultimeve publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore, zbatimit të projekteve të buxhetimit me pjesëmarrje dhe fuqizimit të mekanizmave të kontrollit administrativ, kemi dëshmuar se integriteti institucional ndërtohet përmes veprimeve konkrete dhe jo vetëm përmes deklarimeve.

Njëkohësisht, kemi vazhduar të investojmë në shërbime publike më cilësore, në infrastrukturë, shëndetësi, arsim, zhvillim ekonomik dhe mbështetje sociale, duke siguruar që resurset publike të menaxhohen me përgjegjësi, barazi dhe efikasitet. Bashkëpunimi me institucionet qendrore, partnerët ndërkombëtarë, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin e biznesit ka kontribuar në rritjen e transparencës dhe në forcimin e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve komunale.

Plani i Integritetit mbetet dokumenti ynë udhëzues për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve që mund të cenojnë qeverisjen e mirë. Zbatimi i tij kërkon angazhim të vazhdueshëm nga secili zyrtar publik, profesionalizëm në ushtrimin e detyrës dhe respektim të standardeve më të larta etike.

Si Kryetar i Komunës së Gjilanit, riafirmoj përkushtimin tonë për të vazhduar me politikën e tolerancës zero ndaj korrupsionit, për të forcuar kulturën e integritetit institucional dhe për të garantuar që administrata komunale të mbetet transparente, profesionale dhe në shërbim të çdo qytetari.

Jam i bindur se vetëm përmes qeverisjes me integritet ndërtojmë besim të qëndrueshëm dhe krijojmë themele të sigurt për zhvillimin afatgjatë të Gjilanit.

z. Alban Hyseni,

Kryetari i Komunës së Gjilanit

Hyrja

Në përputhje me nenin 25 të Ligjit nr. 08/l-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe duke iu referuar “Metodologjisë së Planeve të Integritetit”, të gjitha institucionet janë të detyruara të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit.

Komuna e Gjilanit ka realizuar këtë detyrim duke hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024-2026.

Ky plan, i cili ka një periudhë zbatimi trevjeçare dhe përditësohet çdo vit, shërben si një instrument të rëndësishëm për vlerësimin e nivelit të integritetit brenda institucionit. Ai ofron masa të strukturuar për menaxhimin e integritetit, me qëllim që të arrihen objektivat e përcaktuara për këtë fushë.

Raportet dhe Plani i Integritetit mund të gjenden të publikuara në ueb-faqen e Komunës së Gjilanit duke klikuar në linkun e mëposhtëm :

Linku:

<https://gjilan.rks-gov.net/plani-i-integritetit/>

si dhe linku :

<https://gjilan.rks-gov.net/raportet-periodike/>

Plani thekson përkushtimin e komunës së Gjilanit për të forcuar kontrollin e aktiviteteve operative në të gjitha sektorët e veprimit të komunës. Ai përshkruan masat e bazuara në analizën e rrezikut për të arritur objektivat e institucionit, duke u fokusuar në forcimin e sundimit të ligjit dhe promovimin e vlerave dhe standardeve profesionale.

Kjo qasje sistematike dhe e dokumentuar është e nevojshme për të garantuar një nivel më të lartë të integritetit dhe transparencës në administratën lokale, duke kontribuar kështu në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të përgjegjshme.

PERMBAJTJA E PLANI TE INTEGRITET

Përmban elementet e mëposhtëm:

- një vetëvlerësim të ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit dhe formave të tjera të shkeljes së integritetit;
- informacion për fushëveprimin e institucionit dhe burimet njerëzore të angazhuara në institucion;
- llojet e rreziqeve të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit;
- masat ekzistuese të kontrollit;
- masat parandaluese për zvogëlimin e rrezikut të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit dhe afatet për zbatimin e tyre;
- informacion për personin përgjegjës për menaxhimin e hartimit dhe zbatimit të planit të integritetit;
- të dhëna të tjera, në përputhje me Metodologjinë për hartimin e planit të integritetit.

Përmes Planit të Integritetit synohet:

- Rritjen e mundësive që institucionit të arrijë objektivat e menaxhimit të integritetit;
- Identifikimi i rreziqeve dhe masave për zvogëlimin e rreziqeve;
- Përmirësimin e kontrolleve ndaj rreziqeve të identifikuar;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Rritjen e besimit të stafit dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstron nga Institucioni.

Qëllimet e Planit të Integritetit

- Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit;
- Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion.

Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa faza si në vijim:

- Faza e parë: Drejtuesi/personi përgjegjës te institucionit merr vendim për emërimin e një Koordinatorit dhe Grupit Punues për hartimin e Planit të Integritetit. Ky grup pune përbëhet nga anëtarë kredibilvarësi të kompleksitetit të institucioni ose numrit të punonjësve. Grupi punues shqyrton kornizën ligjore (rregulloret, planet, kontrollin e brendshëm të auditimit, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, si dhe burime të tjera informacioni për fushat dhe proceset e punës).
- Faza e dytë: Grupi punues ka mbajtur takime të rregullta me qëllim të përpunimit të të dhënave respektivisht përcaktimit të fushave të rrezikut dhe identifikimit të rreziqeve. Ndër të tjerash, takimet janë mbajtur më datë: 16.02.2023, 13.12.2023 dhe 12.01.2024. Përpos takimeve, jemi konsultuar në vazhdimësi përmes emailit dhe kemi kërkuar që anëtarët e grupit të dërgojnë komentet dhe propozimet e tyre në raport me Planin.
- Faza e tretë: Grupi punues ka përdorur të dhënat e siguruara për t'i përpiluar tabelat e rrezikut dhe të adresoj cënueshmërinë e integritetit dhe propozon masat për përmirësim. Në fund, komuna publikon planin e integritetit dhe miraton masat për përmirësimin e integritetit për periudhën tre (3) vjeçare.

Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga Zyrtari përgjegjës brenda institucionit dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në hartim ashtu edhe në zbatim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rreziku kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioritetet e rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësim duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit nga zyrtari përgjegjës brenda një institucion, raporti duhet të dërgohet për vlerësim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Fushat e rrezikut

Fushat e përgjithshme të Rrezikut

Fushat e përgjithshme të rrezikut shembull janë:

- Drejtimi dhe menaxhimi;
- Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve;
- Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit dhe financave; dhe
- Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumentacionit.

Fushat specifike të rrezikut

Fushat specifike mund të ndryshojnë varësisht nga specifikat e Institucionit.

Fushat e specifike të rrezikut shembull janë:

- Auditimi i brendshëm;
- Prokurimi publik;
- Menaxhimi i kontratave publike;
- Zhvillimi ekonomik lokal dhe bujqësia;
- Planifikimi urban dhe rural;
- Standardet e ndërtimit dhe kontrolli;
- Inspektimet;
- Arsimi publik;
- Shëndeti publik.

Tabela për Zbatimin e Planit të Integritetit-Komuna e Gjilanit – periudha janar – qershor 2026

TË DHËNAT E PLANIT TË INTEGRITETIT						RAPORTIMI I ZBATIMIT				
Nr	Fusha e rrezikut	Përshkrim i i Rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizimit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet
1.	DREJTIMI DHE MENAXHIMI	Komuna e Gjilanit është përballur me rreziqe institucionale me përgjithatë komunikimi me qytetarët është ruajtur.	Rritja e koordinimit institucional dhe transparencës për të zbutur ndikimin e vonesave buxhetore.	Kryetari i Komunës, Drejtoria Komonale	TM1 TM2 2026	Në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës, janë realizuar aktivitete për informimin e qytetarëve lidhur me punën e ekzekutivit komunal. Periudha janar–qershor 2026 shënon një fazë të rëndësishme të konsolidimit institucional dhe të zbatimit të politikave që forcojnë integritetin në Komunën e Gjilanit. Pas miratimit në kohë të buxhetit për vitin 2026, institucionet komunale krijuan kushtet për planifikim më të qëndrueshëm, vendimmarrje më efikase dhe realizim të projekteve në përputhje me interesin publik. Janë prezantuar raportet e punës së Kryetarit të Komunës dhe janë zhvilluar takime publike me qytetarët. Gjithashtu, është zhvilluar bashkëpunimi institucional me organizata dhe partnerë ndërkombëtarë, përfshirë takime me përfaqësues të OSBE-së. Është funksionalizuar përbërja e re e Kuvendit të Komunës përmes zgjedhjes së kryesueses së Kuvendit. Po ashtu edhe drejtoret e rinj emërohen : https://gjilan.rks-gov.net/news/emerohen-drejtoret-e-rinj-te-komunes-se-gjilanit/ https://gjilan.rks-gov.net/news/drejtore-i-administrates-thellon-bashkepunimin-me-ministrine-e-puneve-te-brendshme-ne-gjilan/	E realizuar	https://gjilan.rks-gov.net/lajmet/ https://gjilan.rks-gov.net/news/seanca-inauguruese-e-kuvendit-te-komunes-se-gjilanit-do-te-mbahet-me-10-dhjetor-2025/ https://gjilan.rks-gov.net/news/kryetari-hyseni-priti-drejtorin-e-osbe-se-ne-rajonin-e-gjilanit/ https://gjilan.rks-gov.net/news/kryesueses-e-kuvendit-te-komunes-se-gjilanit/ https://gjilan.rks-gov.net/news/drejtoria-i-administrates-takon-ministrine-administrimit-te-pushtetit-lokal/	Vonesat në proceset vendimmarëse dhe sfidat institucionale kanë ndikuar në ritmin e realizimit të disa aktiviteteve të planifikuara.	Të vazhdohet forcimi i koordinimit ndërmjet organeve komunale, rritja e transparencës dhe komunikimi i vazhdueshëm me qytetarët dhe palët e interesuara.

1.1		Mosmirati mi i buxhetit për vitin 2025 ka rrezikuar funksionim in e institucioni t.	Bashkëpunim intensiv me grupet politike për miratimin e buxhetit.	Kryetari i Komunës, Drejtorit Komunale	TM1 TM2 2026	Kryetari i Komunës ka iniciuar mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit për vitin 2026. Propozim-buxheti u është shpërndarë të gjitha grupeve politike, ndërsa është bërë thirrje publike për bashkëpunim institucional dhe paraqitjen e propozimeve nga subjektet opozitare, me qëllim sigurimin e një procesi transparent, gjithëpërfshirës dhe në interes të qytetarëve. https://gjilan.rks-gov.net/news/kryesueset-e-kuvendeve-te-komunave-te-gjilanit-e-kamenices-flasin-per-avancimin-e-sherbimeve-per-qytetaret/	E realizuar!	https://gjilan.rks-gov.net/news/kryetari-hyseni-therret-seance-te-jashtezakonshme-te-premten-per-miratimin-e-buxhetit/	Vonesat në miratimin e buxhetit si pasojë e mospajtimeve politike dhe nevoja për arritjen e konsensusit ndërmjet subjekteve politike.	Të vazhdohet me planifikimin në kohë të procesit buxhetor, dialogun ndërmjet grupeve politike dhe konsultimet e vazhdueshme
1.2		Objektivat dhe prioritetet zhvillimor e të komunës janë të paqarta dhe jo transparente.	Rishikimi dhe miratimi i Planit Zhvillimor Komunal për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm.	Kryetari i Komunës, Drejtorit Komunale	TM1 TM2 2026	Gjatë periudhës raportuese janë vazhduar aktivitetet për administrimin e çështjeve të urbanizmit dhe planifikimit hapësinor, duke u trajtuar mbi 1,200 lëndë nga Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit. Janë realizuar gjithashtu aktivitetet për sistemin e adresave dhe instalimin e numrave të hyrjeve. Sa i përket rishikimit dhe miratimit të Planit Zhvillimor Komunal, gjatë kësaj periudhe nuk janë shënuar zhvillime të rëndësishme në proces. Me gjithat, Komuna e Gjilanit, në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ka nisur procesin e rindërtimit të zonave kadastrale, me qëllim përditësimin dhe saktësimin e të dhënave pronësore, rritjen e sigurisë juridike dhe krijimin e një sistemi kadastral më transparent e funksional. Projekti përfshin edhe takime informuese me qytetarët për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në proces.	Pjesërisht i realizua	https://gjilan.rks-gov.net/news/kjo-eshte-puna-e-drejtoratit-per-urbanizem-planifikim-dhe-mbrojtje-te-mjedisit-per-vitin-2025/ https://gjilan.rks-gov.net/news/hyseni-po-fillojme-nje-proces-shume-te-rendesishem-per-komunen-tone-rindertimin-e-zonave-kadastrale/ https://gjilan.rks-gov.net/news/kryetari-hyseni-punet-qe-po-bejme-sot-jane-baza-e-ndryshimit-te-madh-qe-kemi-premtuar/	Procedurat e gjata teknike dhe ligjore, koordinimi me institucione të përgjegjëse dhe kompleksiteti i procesit të Planit Zhvillimor Komunal.	Të intensifikohen aktivitetet për përfundimin e procesit të rishikimit të Planit Zhvillimor Komunal.

1.3		Opinion publik negativ dhe humbja e besimit në punën e administratës dhe Kuvendit Komunal	Përditësimi i informacionit dhe funksionalizimi i webfaqes zyrtare për transparencë dhe informim të qytetarëve	Kryetari i Komunës, Drejtorit Komunale	TM1 TM2 2026	Webfaqja zyrtare e Komunës së Gjilanit funksionon në mënyrë të qëndrueshme dhe përditësohet rregullisht me njoftime, vendime, thirrje publike dhe aktivitete që lidhen me zhvillimet në komunë. Publikimi i vazhdueshëm i informatave ka rritur transparencën institucionale, qasjen e qytetarëve në informacion dhe besimin në punën e administratës komunale.	E realizuar!	https://gjilan.rks-gov.net/	Përditësimi në kohë i një numri të madh informacionesh.	Të vazhdohet publikimi i rregullt dhe përmirësimi i përmbajtjes së webfaqes.
1.4		Përfshirja e shoqërisë civile në hartimin e politikave publike komunale ishte e paqartë dhe jo sistematike	Forcimi dhe institucionalizimi i përfshirjes së shoqërisë civile në proceset e hartimit të politikave publike	Kryetari i Komunës OJQ-të Drejtorit Komunale	TM1 TM2 2026	Janë forcuar bashkëpunimet me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë për zhvillimin e politikave dhe shërbimeve publike, përmes takimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta me Siouxland Community Health Center, Academy of Career Planning (Sioux City) dhe institucione kulturore e rinore në SHBA. Gjithashtu, Komuna ka vazhduar mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile përmes thirrjeve publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, duke nxitur pjesëmarrjen e tyre në zhvillimin e komunitetit. https://gjilan.rks-gov.net/news/komuna-e-gjilanit-subvencionon-punesimin-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara/ https://gjilan.rks-gov.net/news/drejtori-huruglica-takon-majorin-amerikan-hogan-e-gjeneralin-warnstadt/ https://gjilan.rks-gov.net/news/drejtori-i-arsimit-viziton-akademine-e-karrieres-ne-sioux-city/	E realizuar!	https://gjilan.rks-gov.net/news/drejtoresha-e-shendetesise-viziton-institucione-shendetesore-e-sociale-ne-siouxland-community-health-center-ne-shba/ https://gjilan.rks-gov.net/news/drejtori-i-kultures-dhe-zyrtare-nga-komuna-vizituan-institucione-kulturore-dhe-rinore-ne-sioux-city/ https://gjilan.rks-gov.net/news/kryesueset-e-kuvendeve-te-komunave-te-gjilanit-e-kamenices-flasin-per-avancimin-e	Përfshirja e kufizuar e organizatave të shoqërisë civile në proceset e hartimit të politikave.	Të zgjerohet bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe të rritet përfshirja e tyre në proceset konsultative dhe vendimarrëse.

								sherbimeve-per-qytetaret/		
1.5		Përgjegjësi të paqarta për monitorimin dhe raportimin e Planit të Integritetit	Përcaktimi i përgjegjësive për monitorimin dhe raportimin e Planit të Integritetit	Kryetari i Komunës Drejtoria Komonale	TM1 TM2 2026	Si koordinator i Planit të Integritetit, kam krijuar hapësirë të veçantë në webfaqen zyrtare të Komunës së Gjilanit për publikimin e Planit të Integritetit dhe raporteve periodike e vjetore. Përmes kësaj hapësire është mundësuar qasje më e lehtë dhe transparente për qytetarët, institucionet dhe palët e interesuara, duke siguruar informim të vazhdueshëm mbi zbatimin e masave të integritetit dhe përmbushjen e obligimeve për transparencë dhe llogaridhënie institucionale.	Në vazhdimësi!	https://gjilan.rks-gov.net/plani-i-integritetit/ https://gjilan.rks-gov.net/raportet-periodike/	Të vazhdohet monitorimi i zbatimit të masave të Planit të Integritetit përmes raportimit periodik.	Të vazhdohet përditësimi i Planit të Integritetit dhe publikimi i raporteve për transparencë të vazhdueshme.
2.	POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE, SJELLJA ETIKE DHE PROFESIONALE E TË PUNËSUARV E	Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesional e të punësuarve	Mos plotësimi i vendeve të punës me staf adekuatë dhe të mjaftueshëm	Kryetari i Komunës Drejtoria Komonale	TM1 TM2 2026	Sipas të dhënave të siguruar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjilanit për vitin 2026 (gjendja e tanishme), komuna ka gjithsej 287 të punësuar, të shpërndarë sipas kategorive, gradave, gjinisë, grupmoshave dhe nivelit të arsimit. Struktura e të punësuarve sipas kategorive : • Nëpunës të shërbimit civil – 228 • Nëpunës të shërbimit publik – 17 • Krijues dhe performues të artit dhe kulturës – 20 • Nëpunës teknikë dhe mbështetës – 11 • Zyrtarë të kabinetit (funksionarë publikë) – 11 Struktura sipas gjinisë • Femra – 120 (41.8%) • Meshkuj – 167 (58.2%)	Në vazhdimësi!	Te gjitha konkurset publikohen në webfaqe : https://gjilan.rks-gov.net/konkurset-njoftimet/	Daljet në pension dhe pozitave të lira kërkojnë vazhdimësi në konkurse	Të vazhdohet me planifikimin dhe zhvillimin me kohë të konkurseve për plotësimin e pozitave të lira.
2.1		Vlerësimi periodik i rezultateve të punës së zyrtarëve	Të përgatiten dhe analizohen raporte të punës për secilin zyrtar	Kryetari i Komunës Drejtoria Komonale	TM1 TM2 2026	Janë përgatitur dhe publikuar raporte të punës nga drejtoritë komunale, ku janë pasqyruar aktivitetet, rezultatet dhe shërbimet e realizuara gjatë periudhës raportuese. Drejtoritë kanë monitoruar zbatimin e detyrave dhe angazhimeve të përcaktuara, duke raportuar për realizimin e objektivave në fusha si administrata, urbanizmi, arsimi, shëndetësia,	E realizuar!	https://gjilan.rks-gov.net/news/administrata-e-gjilanit-ofroi-mbi-92-mije-sherbime-gjate-vitit-2025/	Mbledhja dhe harmonizimi i të dhënave nga njësitë organizativ e kërkon koordinim	Të vazhdohet me raportimin dhe analizimin periodik të rezultateve për

						zhvillimi ekonomik, buxheti dhe shërbimet publike. Përmes këtyre raporteve është mundësuar vlerësimi i performancës së njësive organizative dhe identifikimi i fushave për përmirësim të mëtejshëm. https://gjilan.rks-gov.net/news/isufi-do-te-mbeshtesim-zhvillimin-e-bujqesise-edhe-kete-vit/ https://gjilan.rks-gov.net/news/rexhepi-prioritet-e-kemi-zhvillimin-e-arsimit-dual-dhe-ate-profesional/ https://gjilan.rks-gov.net/news/ndihmohen-150-familje-ne-nevoje-ne-gjilan/		https://gjilan.rks-gov.net/news/dr-kamberi-sherbimi-shtepiak-ofroi-mijra-sherbime-cilesore-dhe-ne-kohe-per-pacientet-ne-nevoje/ https://gjilan.rks-gov.net/news/ndizet-flakadani-i-manifestimit-flaka-e-janarit-2026/	të vazhdueshëm ndërmjet drejtorive.	përmirësimi në performancën institucionale.
2.2		Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarave në përputhje me planin dhe nevojat për trajnime	Njësia e Burimeve Njerëzore, Drejtoret e Drejtorive	Kryetari i Komunës Drejtorit Komunalë	TM1 TM2 2026	Gjatë periudhës janar–qershor 2026 janë realizuar aktivitete për ngritjen e kapaciteteve profesionale të të punësuarve komunalë përmes pjesëmarrjes në vizita studimore, takime profesionale, punëtori dhe shkëmbime të praktikave të mira. Në muajin maj 2026, përfaqësues të Komunës së Gjilanit kanë marrë pjesë në vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku janë zhvilluar takime me institucione dhe departamente të ndryshme në Sioux City, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në menaxhimin institucional, mbrojtjen dhe shpëtimin, menaxhimin e emergjencave dhe sigurinë publike. https://gjilan.rks-gov.net/news/drejtori-i-kultures-dhe-zyrtare-nga-komuna-vizituan-institucione-kulturore-dhe-rinore-ne-sioux-city/	Në vazhdimësi	https://gjilan.rks-gov.net/news/drejtoret-shendetesise-viziton-institucione-shendetesore-e-sociale-ne-siouxland-community-health-center-ne-shba/	Mundësi të kufizuara për përfshirjen e të gjithë stafit në vizita ndërkombëtare për shkak të kapaciteteve organizativë dhe financiare.	Të hartohet një plan më i detajuar vjetor i trajnimeve bazuar në nevojat reale të drejtorive komunale.
2.3		Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë	Kryetari i komunës dhe i Kuvendit,	Kryetari i Komunës	TM1 TM2 2026	Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Njësia e Personelit ka vazhduar zbatimin dhe promovimin e parimeve të Kodit të Etikës Komunale në kuadër të administratës komunale,	E realizuar!	https://www.bota.sot.info/gjilani-kosova/1027281/gjilani-miraton-	Mungesa e trajnimeve dhe aktiviteteve	Të organizohen trajnime dhe sesione

		zyrtaret komunal.	Njësia e Burimeve Njerëzore,	Drejtorit Komunale		duke u bazuar në dokumentet ekzistuese institucionale. Përmes komunikimeve të brendshme dhe aktiviteteve të administratës është rikujtuar rëndësia e respektimit të standardeve etike, integritetit profesional, transparencës dhe përgjegjshmërisë gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare. Aktivitetet e realizuara nga drejtoritë komunale dhe bashkëpunimet institucionale gjatë kësaj periudhe kanë kontribuar në forcimin e kulturës së integritetit dhe në promovimin e administrimit të përgjegjshëm publik.		kodin-e-etikes-komunale/ Kodi i Etikës Komunale i miratuar nga Komuna e Gjiçanit në vitin 2019, prandaj po fokusohemi vetëm në vazhdimin e zbatimit	të rregullta vetëdijësuese për të gjithë zyrtarët komunalë mund të ndikojë në zbatimin e njëtrajtshëm të parimeve të Kodit të Etikës.	informuese periodike
2.4		Mospranimi dhe trajtimin në mënyrë adekuate të informatave sinjalizimeve nga sinjalizuesit/informatorët	Caktimi i zyrtarit përgjegjës për sinjalizim	Kryetari i Komunës Drejtorit Komunale	TM1 TM2 2026	Komuna e Gjiçanit ka vazhduar zbatimin e dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, duke siguruar funksionimin e mekanizmit të brendshëm për sinjalizim. Është caktuar zyrtari përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve, në përputhje me vendimin komunal dhe kërkesat ligjore. Gjithashtu, në ueb-faqen zyrtare të Komunës është funksionalizuar seksioni "Sinjalizuesi", përmes të cilit qytetarët dhe zyrtarët komunalë informohen mbi procedurat e sinjalizimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.	Ne vazhdimësi	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18303	Numëri i ulët i sinjalizimeve dhe nevoja për rritjen e besimit të qytetarëve dhe zyrtarëve në mekanizmin e sinjalizimit	Rritjen e numrit të sinjalizimeve
3.	PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I BUXHETIT DHE FINANCAVE	Planifikimi jo adekuat i buxhetit vjetor komunal	Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit.	Kryetari i Komunës Drejtorit Komunale	TM1 TM2 2026	Komuna e Gjiçanit ka ndërmarrë veprime për të siguruar pjesëmarrjen e palëve relevante në procesin e planifikimit buxhetor, duke organizuar degjimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027–2029 më 22 qershor 2026. Përmes njoftimit publik dhe ftesës së hapur, qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, përfaqësuesit e komuniteteve dhe palët e tjera të interesit janë ftuar të kontribuojnë me propozime dhe komente në hartimin e prioritetve buxhetore të komunës.	Ne vazhdimësi	https://gjilan.rks-gov.net/news/me-22-qershor-2026-do-te-mbahet-degjimi-publik-per-kornizen-afatmesme-buxhetore-kab-2027-2029/ https://gjilan.rks-gov.net/news/umabajt-degjimi-	Pjesëmarrja jo e mjaftueshme e qytetarëve dhe disa grupeve të interesit në procesin e konsultimeve publike.	Të intensifikohet informimi dhe promovimi i dëgjimeve publike,

						Procesi ka synuar rritjen e transparencës, pjesëmarrjes qytetare dhe përfshirjes së interesit publik në planifikimin e buxhetit. https://gjilan.rks-gov.net/news/kjo-eshte-puna-e-drejtoratit-per-buxhet-dhe-financa-per-vitin-2025/ https://gjilan.rks-gov.net/news/fillon-procesi-i-implementimit-te-disa-projekteve-qe-kane-dale-nga-procesi-i-buxhetimit-me-pjesemarrje/ https://gjilan.rks-gov.net/news/kastrati-pagesa-e-tatimit-ne-prone-garanton-investime-mos-pagesa-sjell-masa-ligjore/		publik-per-kornizen-afatmesme-buxhetore-2027-2029/ https://gjilan.rks-gov.net/news/kast-rati-pagesa-e-tatimit-ne-prone-kontribuon-drejtperdrejt-ne-zhvillimin-e-projekteve-dhe-sherbimeve-komunale/		
3.1		Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate dhe jo mjaftueshëm transparent	Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore.	Kryetari i Komunës, Drejtorit Komunale	TM1 TM2 2026	Gjatë periudhës janar–qershor 2026 është siguruar raportimi i rregullt për realizimin e buxhetit komunal. Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka prezantuar në Kuvendin Komunal Raportin Financiar për periudhën janar–mars 2026, duke mundësuar diskutimin nga anëtarët e Kuvendit dhe rritjen e transparencës në menaxhimin e financave publike. Gjithashtu, Kuvendi ka shqyrtuar dhe miratuar vendimet lidhur me bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake dhe rritjen e buxhetit nga tejkalimi i realizimit të të hyrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi. https://gjilan.rks-gov.net/news/kuvendaret-e-gjilanit-miratojne-kornizen-afatmesme-buxhetore-kab-2027-2029/	E realizuar!	https://rajonipress.com/kuvendaret-e-gjilanit-diskutojne-per-raportin-financiar-janar-mars-2026/ https://gjilan.rks-gov.net/news/kuvendaret-e-gjilanit-diskutojne-per-raportin-financiar-janar-dhjetor-2025/	Nevoja për përmirësimin e informimit publik dhe interesimit të qytetarëve për raportet periodike financiare dhe proceset e mbikëqyrjes së shpenzimeve buxhetore.	Të vazhdohet raportimi periodik dhe publikimi në kohë i raporteve financiare,
3.2		Të sigurohet mbikëqyrja e jashtme mbi zbatimin e buxhetit duke	Kryetari i komunës dhe Drejtoria për buxhet dhe financa	Kryetari i Komunës Drejtorit Komunale	TM1 TM2 2026	Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Komuna e Gjilanit është përzgjedhur si një nga komunat përfituese të mbështetjes teknike dhe mentorimit në kuadër të projektit "Forcimi i Demokracisë Pjesëmarrëse (2025–2028)", të zbatuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK), me mbështetjen e Programit ReLOaD3 të financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNDP.	Ne realizim	https://www.facebook.com/asociacionikomunavekosoves/posts/akk-dot%C3%AB-ofroj%C3%AB-mb%C3%ABshtetje-teknike-	Mekanizmat e mbikëqyrjes së jashtme janë ende në fazën e institucionale	Të vazhdohet implementimi i aktiviteteve të Programit ReLOaD3

		krijuar një komision të përbërë nga përfaqësuesit e komunës dhe nga vëzhgues të OJQ-ve për të monitoruar zbatimin e buxhetit.				Mbështetja do të fokusohet në institucionalizimin e standardeve për menaxhimin transparent të fondeve publike dhe forcimin e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, duke krijuar bazë për rritjen e mbikëqyrjes së jashtme dhe transparencës në zbatimin e buxhetit komunal.		p%C3%ABr-komunat-p%C3%ABrfituese-t%C3%AB-projektit-fuqizimi/967541072998162/https://gjilan.rks.gov.net/news/kuvendaret-e-gjilanit-miratojne-buxhetin-per-vitin-2026-ne-shumen-prej-afer-42-milione-euro/	lizimit dhe kërkojnë koordinim të vazhdueshëm ndërmjet komunës, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve të projektit.	
4.	RUAJTJA DHE SIGURIA E TË DHËNAVE DHE DOKUMENTACIONIT	Siguria e pamjaftueshme e të dhënave në sistemet e teknologjisë informativ e si dhe përdorimi i tyre për qëllime jo-zyrtare		Kryetari i Komunës Drejtorit Komunale Zyra e IT	TM1 TM2 2026	Sistemet e teknologjisë informative vazhdojnë të monitorohen dhe mirëmbahen në përputhje me udhëzimet e Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI) dhe legjislacionin në fuqi. Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Komuna e Gjilanit ka avancuar shërbimet digjitale dhe qasjen e qytetarëve në informacion publik përmes funksionalizimit të internetit falas në hapësirat më të frekuentuara të qytetit, duke lehtësuar qasjen në shërbimet elektronike dhe informacionet zyrtare të komunës. Gjithashtu, vazhdon funksionimi i ueb-faqes zyrtare të komunës, e cila shërben si kanal zyrtar për publikimin e dokumenteve dhe informacioneve institucionale.	Ne vazhdimësi	https://gjilan.rks.gov.net/news/internet-falas-ne-gjilan-ne-vendet-me-te-frekuentuara-nga-qytetaret/	Kapacitete të kufizuara teknike dhe burime të kufizuara për zbatimin e plotë të të gjitha masave të sigurisë së informacionit dhe monitorimin e vazhdueshëm të sistemeve.	Të vazhdohet investimi në sigurinë e sistemeve të teknologjisë informative,
4.1		Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes		Kryetari i Komunës Drejtorit Komunale Zyra e IT	TM1 TM2 2026	Gjatë periudhës janar–qershor 2026 nuk janë evidentuar ndryshime të veçanta në procedurat e menaxhimit dhe sigurisë së të dhënave. Procedurat dhe masat ekzistuese kanë vazhduar të zbatohen në përputhje me politikat dhe udhëzimet në fuqi për mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e sistemeve të teknologjisë informative.	Ne vazhdimësi	https://ekosova.rks.gov.net/PrivacyPolicy/	Sfidat e vazhdueshme të sigurisë në një mjedis teknologjik që zhvillohet	Të vazhdohet rishikimi periodik i procedurave dhe zbatimi i standardeve të reja të

		sistemeve të teknologjisë informativ e							me ritme të shpejta.	sigurisë së informacionit,
TË DHËNAT E PLANIT TË INTEGRITETIT						RAPORTIMI I ZBATIMIT				
1.	AUDITIMI I BRENDSHËM	Mungesa e planifikimit të auditimit të bazuar në rrezik dhe auditimeve rast pas rasti	Hartimi i planit të auditimit të brendshëm bazuar në rezultatin e vlerësimit të rrezikut	Kryetari i Komunës Drejtorit Komunale	TM1 TM2 2026	Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka zbatuar aktivitetet e auditimit në përputhje me Planin Strategjik dhe Planin Vjetor të Auditimit, të hartuara mbi bazën e vlerësimit të rrezikut. Auditimet janë realizuar sipas standardeve profesionale dhe metodologjisë së auditimit të brendshëm, me hartimin e raporteve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e kontroleve të brendshme dhe menaxhimin e rrezikut në komunë.	Ne vazhdimësi	https://gjilan.rks.gov.net/njesia-e-auditimit-te-brendshem/ https://zka-rks.org/cms/ReportFiles/2026_aee71881-31ac-4075-8f77-cddc407bc735.pdf	Burime të kufizuara njerëzore për realizimin e të gjitha auditimeve të planifikuara	Të vazhdohet planifikimi i auditimeve bazuar në vlerësimin e rrezikut,
1.1		Auditimet rast pas rasti	Mosverifikimi i plotë i të gjeturave nga inspektimet	Kryetari i Komunës Drejtorit Komunale	TM1 TM2 2026	Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka vazhduar zbatimin e Planit Strategjik dhe Planit Vjetor të Auditimit, të bazuara në vlerësimin e rrezikut. Njësia ka vazhduar monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit dhe raportimin periodik pranë Kryetarit të Komunës dhe Komisionit të Auditimit, në përputhje me legjislacionin dhe standardet profesionale.	Ne vazhdimësi	https://zka-rks.org/ ; https://gjilan.rks.gov.net/njesia-e-auditimit-te-brendshem/	Kapacitetet njerëzore të kufizuara dhe nevoja për auditime shitesë në rastet me rrezik të lartë.	Të planifikohe n auditime të veçanta (ad hoc)
1.2	Koordinimi ndërinstitucional në auditim	Mungesë koordinimi ndërmjet Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komisionit të Auditimit,	Përmirësimi i komunikimit dhe koordinimit ndërinstitucional	Kryetari i Komunës Drejtorit Komunale	TM1 TM2 2026	Gjatë periudhës janar–qershor 2026, është vazhduar koordinimi ndërmjet Njesisë së Auditimit të Brendshëm, Komisionit të Auditimit dhe njësive organizative të komunës për zbatimin e Planit Vjetor të Auditimit, monitorimin e rekomandimeve të auditimit dhe përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në përputhje me procedurat dhe standardet e auditimit të brendshëm.	Në proces! https://zka-rks.org/ ; https://gjilan.rks.gov.net/njesia-e-auditimit-te-brendshem/	https://zka-rks.org/ ; https://gjilan.rks.gov.net/njesia-e-auditimit-te-brendshem/	Nevoja për koordinim më të madh ndërmjet njësive organizative dhe zbatimin në afat të rekomandimeve të auditimit.	Të forcohet komunikimi i rregullt ndërmjet Njesisë së Auditimit të Brendshëm, Komisionit të Auditimit dhe drejtorive komunale,

2.	PROKURIMI PUBLIK	Kapacitete të pamjaftueshme në përgatitjen e specifikimeve të tenderit dhe rrezik i diskriminimit	Rritja e kapaciteteve dhe hartimi i specifikimeve neutrale	Kryetari i Komunës Drejtorit Komunale	TM1 TM2 2026	Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Zyra e Prokurimit e Komunës së Gjilanit ka zhvilluar procedurat e prokurimit publik në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, duke përgatitur dokumentacionin e tenderëve dhe specifikimet teknike në bashkëpunim me njësitë kërkuese. Të gjitha njoftimet për kontratë dhe aktivitetet e prokurimit janë publikuar në platformën elektronike të prokurimit dhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Gjilanit, me qëllim garantimin e transparencës dhe konkurrencës.	E realizuar!	https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/CiAnakItemNew.aspx https://gjilan.rks-gov.net/njoftim-per-kontrate	Nevoja për koordinim më të madh ndërmjet njërive organizativ e dhe Zyres së Prokurimit.	E gjitha në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2.1	Përgatitja e specifikimeve të tenderit	Përgatitje joefikase e specifikimeve të tenderit	Rritja e transparencës dhe mbikëqyrjes në procesin e prokurimit	Kryetari i Komunës Drejtorit Komunale	TM1 TM2 2026	Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Komuna e Gjilanit ka siguruar publikimin e të gjitha njoftimeve për kontratë, dokumentacionit të tenderëve dhe vendimeve përkatëse përmes platformës elektronike e-Prokurimi dhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe standardet e KRPP-së. Komunikimi me operatorët ekonomikë është zhvilluar ekskluzivisht përmes platformës elektronike, duke rritur transparencën, barazinë në trajtim procedurave të prokurimit.	E realizuar!	https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/CiAnakItemNew.aspx/ https://gjilan.rks-gov.net/njoftim-per-kontrate/	Nevoja për ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të operatorëve ekonomikë në përdorimin e platformës elektronike	Sigurimi i një procesi sa më transparent dhe konkurrues.
2.2	Transparenca në prokurimin publik	Mos-transparenca dhe mbikëqyrje e pamjaftueshme e prokurimit publik	Publikimi i Planit të Prokurimit dhe informacioneve relevante	Kryetari i Komunës Drejtorit Komunale	TM1 TM2 2026	Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Komuna e Gjilanit ka publikuar Planin e Prokurimit, njoftimet për kontratë dhe dokumentacionin përkatës në platformën elektronike e-Prokurimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të vazhdohet publikimi në kohë i dokumenteve të prokurimit dhe të rritet informimi i operatorëve ekonomikë dhe qytetarëve për përdorimin e platformës e-Prokurimi dhe mekanizmeve të ankesave pranë OSHP-së. Mekanizmat për shqyrtimin e ankesave kanë mbetur të qasshëm për operatorët ekonomikë përmes Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), duke garantuar transparencë dhe mbrojtje të drejtave në procedurat e prokurimit.	E realizuar!	https://oshp.rks-gov.net/ https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/CiAnakItemNew.aspx?id=205/ https://gjilan.rks-gov.net/news/kryetari-hyseni-edhe-kete-vite-ekskursioni-per-maturantet-e-gjilanit-eshte-falas/	Njohuri të kufizuara të një pjese të operatorëve ekonomikë dhe qytetarëve për përdorimin e platformave elektronike	Informim dhe udhëzime publike për rritjen e qasjes dhe monitorimit qytetar

2.3	Komunikimi me ofertuesit në prokurim	Mundësi për komunikim joformal dhe jo të kontrolluar me ofertuesit	Krijimi i protokollit të qartë dhe pikave zyrtare të kontaktit	Kryetari i Komunës Drejtori i Komunale	TM1 TM2 2026	Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Komuna e Gjiçanit ka vazhduar zbatimin e Rregullores (KGJ) Nr. 1/2025 për Transparencë, duke publikuar në mënyrë të rregullt vendimet, njoftimet, dokumentet zyrtare, thirrjet publike dhe aktivitetet institucionale në ueb-faqen zyrtare të komunës, në përputhje me parimet e transparencës dhe qasjes në dokumente publike.	E realizuar!	https://gjiçan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Rregullorja-per-transparence-komunale-2025.pdf/	Nuk janë evidentuar vështirësi të veçanta gjatë zbatimit të kësaj mase.	Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies institucionale.
3.	MENAXHIMI I KONTRATAVE PUBLIKE	Mungesë e stafit profesional për menaxhimin e kontratave	Menaxhimi i kontratave nga zyrtarë me kompetencë profesionale.	Njësia e Prokurimit Publik	TM1 TM2 2026	Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Njësia e Prokurimit Publik ka zhvilluar procedurat e prokurimit dhe ka monitoruar zbatimin e kontratave në përputhje me Planin e Prokurimit dhe legjislacionin në fuqi. Zbatimi i kontratave është përcjellë në bashkëpunim me menaxherët e kontratave dhe njësitë kërkuuese, me qëllim sigurimin e realizimit të obligimeve kontraktuale. Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Komuna e Gjiçanit ka vazhduar realizimin e projektit kapital për ndërtimin e Bulevardit të Qytetit, investimi më i madh në historinë e komunës. Projekti përfshin ndërtimin e objektit të ri të administratës komunale, parkingjeve nëntokësore, nënkalimeve, hapësirave publike dhe gjelbëruese, me synim modernizimin e infrastrukturës urbane dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët.	E realizuar!	https://gjiçan.rks-gov.net/raportet-12/ https://gjiçan.rks-gov.net/news/kryetari-hyseni-mega-projekti-per-gjiçanin-po-behet-realitet/	Nevoja për ekspertizë shtesë në menaxhimin e kontratave komplekse dhe koordinim më të madh ndërmjet menaxherëve të kontratave dhe njësive kërkuuese.	Të planifikohet pjesëmarrja e rregullt e zyrtarëve komunalë në trajnimet e KRPP-së dhe IKAP-it, me qëllim përditësimin e njohurive dhe forcimin e kapaciteteve për menaxhimin efektiv të kontratave.
3.1	Kapacitetet për menaxhimin e kontratave	Mungesë e aftësive profesionale për menaxhimin e kontratave	Trajnimi i zyrtarëve për menaxhimin e kontratave	Njësia e Prokurimit Publik	TM1 TM2 2026	Gjatë periudhës janar–qershor 2026, zyrtarët e Komunës së Gjiçanit kanë pasur në dispozicion programet e trajnimit të organizuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP), me qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e menaxhimit të kontratave dhe zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik. Platforma e IKAP-it shërben për organizimin dhe menaxhimin e trajnimeve dhe certifikimeve	E realizuar!	https://krpp.rks-gov.net/ https://ikap.rks-gov.net/m	Ngarkesa me detyra të rregullta dhe kufizimet kohore për pjesëmarrjet të vazhdueshme në trajnimet	Planifikim më i mirë i pjesëmarrjes dhe vazhdimi i trajnimeve periodike

						të zyrtarëve publikë, me qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e cilësisë së administratës publike në Kosovë.			profesional e.	
4.	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE BUJQËSIA	Mos-rishikimi dhe miratimi i dokumenteve strategjike dhe masave për zhvillim ekonomik dhe mbështetje të bizneseve	Hartimi, rishikimi dhe miratimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik të komunës	Kryetari i komunës Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	TM1 TM2 2026	Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Komuna e Gjilanit ka ndërmarrë hapa konkretë për krijimin e Parkut Industrial, duke nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit. Projekti synon të krijojë kushte për investime të reja, zhvillimin e sektorit prodhues dhe hapjen e vendeve të reja të punës në komunë. Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Komuna e Gjilanit ka promovuar projektin për zhvillimin e Liqenit të Livoçit si zonë rekreative dhe turistike, me synim valorizimin e potencialit natyror, përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillim ekonomik lokal dhe turizëm.	Në proces!	https://gjilan.rks-gov.net/news/hyseni-gjilanin-do-ta-bejme-nje-qender-te-rendesishme-te-zhvillimit-ekonomik-dhe-industrial/ https://gjilan.rks-gov.net/news/kryetari-hyseni-liqeni-i-livocit-ka-nje-potencial-te-jashtezakonsheper-tu-zhvilluar/	Nevoja për sigurimin e burimeve financiare, koordinim ndërinstytucional dhe përfundimi në procedurave të teknike administrative për realizimin e projekteve zhvillimore.	Të vazhdohet puna për finalizimin e projekteve strategjike, sigurimin e investimeve dhe krijimin e kushteve për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe rritjen e atraktivitetit turistik të komunës.
